



Komisioni i
Pavarur i
Kualifikimit

NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR

SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT Znj. PRANVERA STAFA SELITA



08/03/2024

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 6.3.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa Selita, bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit znj. Pranvera Stafa Selita, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, znj. Brunilda Bekteshi relatore, z. Lulzim Hamitaj anëtar do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 8.3.2024.

Informacioni është aksesuar në faqen zyrtare të KPK në linkun: <https://kpk.al/njoftim-mbi-seancen-e-shpalljes-se-vendimit-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-pranvera-stafa-selita/34/>